



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 74 të Ligjit Nr.06/L-114 për zyrtarët publik, nenit 18 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për disiplinën dhe ankesat e zyrtarëve publikë si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës nxjerr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

Neni 1

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të stafit shëndetësor dhe të aplikantëve për punësim në stafin shëndetësor në kuadër të Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale të Komunës së Lipjanit, në këtë përbërje:

1. Lorik Berbatovci –Qendra për punë Sociale, Kryesues
2. Blerim Reçica , QKMF- Lipjan, anëtar
3. Rafete Retkoceri, juriste në DSHP, anëtare

Neni 2

Detyrë e Komisionit është shqyrtimi i ankesave nga marrëdhënia e punës të stafit shëndetësor të cilët vlerësojnë se u janë shkelur të drejtat nga marrëdhënia e punës dhe të aplikantëve për punësim në stafin shëndetësor konform dispozitave të nenit 74 të Ligjit Nr.06/L-114 për zyrtarët publik dhe nenit 18 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për disiplinën dhe ankesat e zyrtarëve publikë.

Komisioni ka për detyrë që ankesat ti shqyrtojë dhe të vendosë brenda afatit 15 ditor nga dita e pranimit.

Mandati i Komisionit është tre vjeçar.

Neni 3

Punët e pranimit të ankesave dhe punët tjera administrativo-juridike për Komisionin do ti kryej Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit .

1Nr. 112-3815
Lipjan, më 18.01.2021

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

